



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-3530/14
Dep. 02	Bi Prot. Prot No
	Data 09.10.2014
	Datum
	Date
	ORISHINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.10.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-1691/14, për z. Bashkim Berisha – Drejtor i Auditimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1691/14, për z. Bashkim Berisha – Drejtor i Auditimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Berisha është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “Euro Metali”.

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t'i bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

Gjatë takimit z. Berisha, është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 3459/14) me të cilën vërtetohet se në biznesin privat “Euro Metali” ka emëruar një person të besueshëm si person të autorizuar. Me këtë z. Berisha ka shmangur situatën e konfliktit të mundshëm të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

